



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:233758
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05503939

C.nr.308/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.. me seli në Prishtinë, rruga .., të cilën e përfaqëson V.. SH.P.K, me seli në Fushë Kosovë, rruga .. me autorizim F. L., kundër të paditurit H.L nga ish Vushtrria, rruga .., me objekt kontesti rimbursim dëmi, jashtë seance më datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të vdekjes së të paditurit H.L nga Vushtrria, rruga ..
- II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurit e marrin përsipër procedurën apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësja B.. me seli në Prishtinë, rruga .. të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania “V. SH.P.K me seli në Fushë Kosovë, rruga .., ka paraqitur padi me datë 09.07.2018, kundër të paditurit H.L nga Vushtrria, rruga .., me objekt kontesti Rimbursim dëmi.

Gjykata me datë 26.03.2024, ka mbajtur seancën përgatitore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i paditëses, ndërsa ka munguar i padituri H.L, për të cilin në bazë të fletëkthesës së datës 27.02.2024, ishte konstatuar se pala ka ndërruar jetë. Ndërsa me qëllim të konstatimit të saktë të faktit të vdekjes për të paditurin, gjykata ka siguruar nga Komuna e Vushtrrisë- Zyra e Gjendjes Civile edhe certifikatën e vdekjes me nr. rendor 619 të datës 25.03.2024.

andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.308/18, me datë 26.03.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.